

## DOKUMENTACIONI PËR KANDIDIDIM

- a) Formular aplikimi për kandidim e cila përmban: emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim (formularin mund ta shkarkoni në faqen WEB: <http://uniel.edu.al/index.php/al/njoftime> ;
- b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) Kopje të noterizuar të gradës/titullit akademik;
- d) Dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar.
- e) Formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund ti shkarkoni në faqen WEB: <http://uniel.edu.al/index.php/al/njoftime>) për:
  - Deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje pavarësisht kohëzgjatjes si autoritet drejtues në postin për të cilin kandidon në Universitetin e Elbasanit “A. Xhuvani”;
  - Vetëdeklarim për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik (mungesë plagjiature)
  - Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
  - Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Dokumentet e kandidimit për studentët anëtarë të Senatit Akademik dorëzohen në KIZ dhe përmbajnë:

- a- Formularin për kandidim e cila përfshin, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim (formularin mund ta shkarkoni në faqen WEB: <http://uniel.edu.al/index.php/al/njoftime>;
- b- Kopje të dokumentit të identifikimit;
- c- Vërtetim që vërteton se është student me kohë të plotë në Universitetin e Elbasanit “A. Xhuvani”;
- d- Propozimi nga jo më pak se 100 studentë pjesë e trupës zgjedhore.